RREGULLORE

"PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E BORDIT TË ADMINISTRIMIT TË ALBANIAN UNIVERSITY"

Miratohet

Kryetari i Bordit të Administrimit

Amanda Vrioni

Tiranë, më 22.12.2016

Neni 1

Me këtë Rregullore, përcaktohen rregullat mbi mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Bordit të Administrimit të Albanian University (këtu e në vazhdim AU), organizimin e mbledhjeve, kryesimin dhe vendimmarrjen, zbatimin e vendimeve dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me punën e Bordit të Administrimit.

Neni 2

Në zbatim të nenit 22, pika 1 të Statutit të Albanian University, Bordi i Administrimit është organi më i lartë kolegjial administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të institucionit të arsimit të lartë, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij.

Neni 3

1. Bordi i Administrimit të AU ushtron këto kompetenca kryesore:
   a. garanton qëndrueshmërinë financiare të institucionit të arsimit të lartë dhe përmbushjen e misionit të tij;
   b. me propozim të Senatit Akademik, miraton planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tij;
   c. me propozim të Senatit Akademik, miraton buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tyre;
   d. me propozim të Senatit Akademik, miraton numrin e personelit akademik në të gjitha nivelet;
   e. vlerëson paraprakisht mbylljen dhe riorganizimin e institucionit të arsimit të lartë, si dhe ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë me një institucion tjetër të arsimit të lartë;
   f. miraton paraprakisht hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësive përbërëse të institucionit të arsimit të lartë;
   g. jep mendim për projekt rregulloren e institucionit dhe miraton rregulloren financiare të tij;
   h. përcakton rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që siguron institucioni nga ushtrimi i veprimtarive të tij, si dhe mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit;
   i. është përgjegjës për caktimin e kritereve e të procedurave për punësimin e Administratorëve dhe personelit administrativ, mbështetur në aktet e institucionit të arsimit të lartë;
   j. emëron dhe shkarkon Administratorin e përgjithshëm të AU; Administratorët e njësive kryesore, si dhe personelin administrativ, mbi bazë të propozimeve të Administratorit të SHT;
   k. miraton raportin vjetor të veprimtarisë financiare së institucionit, të hartuar nga Rektorati.

2. Kompetenca të tjera të Bordit të Administrimit janë:

   a. i propozon Senatit ndryshime në nivelin e pagave si dhe ndryshimin e tarifës së orës mësimore, pasi i ka miratuar ato paraprakisht në mbledhjen e tij të radhës;

2. Në mbledhjet e Bordit të Administrimit, për çështje të caktuara mund të ftohen të marrin pjesë pa të drejtë vote edhe anëtarë të stafit akademik, dhe/ose administrativ, për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre.

Neni 8

1. Mbledhjet e Bordit të Administrimit thirret dhe i kryeson nga Kryetari i Bordit të Administrimit.
2. Rendi i ditës së bashku me materialet për shqyrtim u dërgohen anëtarëve të Bordit të Administrimit të paktën 5 (pesë) ditë pune para mbajtjes së mbledhjes.
3. Bordi mblidhet rregullisht 3 (tre) herë në një tremestër, por Bordi i Administrimit mund të mbajë edhe mbledhje të jashtëzakonshme.
4. Gjatë përpilimit të rendit të ditës, Kryetari kujdeset posaçërisht që:

a. në rendin e ditës të përfshihen çështjet të cilat sipas Statutit i përkasin fushëveprimit dhe kompetencave të Bordit të Administrimit;
b. në rendin e ditës të përfshihen edhe ato çështje që kërkojnë zgjidhje në afate të caktuara kohore.

5. Kryetari, përgatit dhe propozon rendin e ditës në bashkëpunim me Administratorin e Përgjithshëm të AU, dhe Administratorët e njësive kryesore.
6. Kryetari është i detyruar të thërrasë mbledhjen e jashtëzakonshme të Bordit edhe nëse atë e kërkon 1/3 e anëtarëve të tij, si dhe ai vetë, si Administrator i SHT.

Neni 9

1. Në fillim të mbledhjes, Kryetari konstaton se kush është i pranishëm dhe kush mungon, konstaton se a ka kuorum, konstaton nëse ka ndonjë konflikt interesi të deklaruar, propozon rendin e ditës dhe hap diskutim rreth tij.
2. Anëtarët e Bordit kanë të drejtë të propozojnë ndryshimin dhe plotësimin e rendit të ditës.
3. Kryetari i Bordit konstaton miratimin e rendit të ditës. Rendi i ditës pas miratimit nuk mund të ndryshohet.

Neni 10

1. Pas miratimit të rendit të ditës, kalohet në shqyrtim dhe vendoset për çështjet që janë në kuadër të pikave të rendit të ditës. Raportin dhe arsyetimin rreth pikës së rendit të ditës e paraqet kryetari i Bordit, ose personi i caktuar pas të cilit Kryetari hap diskutimin.
2. Anëtarët e Bordit marrin pjesë në diskutime dhe paraqesin mendimet dhe propozimet lidhur me çështjet të cilat trajtohen në mbledhje.
3. Kryetari e jep fjalën sipas radhës së paraqitjes për diskutim.
4. Në mbledhjet e Bordit askush nuk mund të ndërhyjë në diskutime pa e marrë fjalën nga Kryetari i Bordit, dhe duke ngritur dorën.
5. Për çdo pikë të rendit të ditës pjesëmarrësit mund të diskutojnë më së shumti 2 (dy) herë. Ata kanë edhe të drejtën e replikës.

ALBANIAN UNIVERSITY AU

6. Pjesëmarrësi, i cili e merr fjalën është i detyruar t'i përmbahet çështjes që është në shqyrtim dhe mund të flasë vetëm rreth pikës që është në rend të ditës.

Neni 11

1. Para se të votohet, kryetari i Bordit formulon propozimet e vendimit ose konkluzionet lidhur me atë pikë të rendit të ditës.
2. Pas shqyrtimit dhe përfundimit të diskutimeve, sipas pikës së rendit të ditës, Bordi merr vendim.
3. Bordi vendos në mënyrë unanime kur në mbledhje janë të pranishëm më tepër se gjysma e numrit të plotë të anëtarëve me të drejtë vote.
4. Vendimet e Bordit merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve me të drejtë vote.
5. Në rast se votat pro dhe kundër, për një çështje të caktuar, janë në numër të barabartë, vendimtare është vota e Kryetarit të Bordit.

Neni 12

1. Kryetari dhe anëtarët e Bordit janë të detyruar që t'i përmbahen kësaj Rregullore.
2. Mbledhja e caktuar e Bordit mund të shtyhet ose të ndërpritet vetëm në këto raste:

a. nëse nuk ka kuorum;
b. nëse çështjet e përcaktuara në rendin e ditës nuk arrijnë të diskutohen brenda të njëjtës mbledhje;
c. kryetari për arsyes shëndetësore, ose pamundësie nuk është në gjendje të kryesojë mbledhjen.

3. Mbledhjen e ndërpret apo e shtyn kryetari i Bordit.

Neni 13

1. Anëtari i Bordit të Administrimit ka këto të drejta dhe detyrime:

a. të përgatitet për mbledhje dhe të marrë pjesë aktive në shqyrtimin e çështjeve që janë në rend dite;
b. të propozojë ndryshimin dhe plotësimin e rendit të ditës;
c. të votojë ose abstenojë; dhe t'i parashtrojë pyetje kryetarit të Bordit.

2. Anëtari i Bordit është i detyruar të marrë pjesë në çdo mbledhje dhe duhet të ketë arsye për mungesë në mbledhje.

Neni 14

1. Diskutimet e zhvilluara në mbledhjet e Bordit pasqyrohen në procesverbalin e mbledhjes, i cili nënshkruhet nga mbajtësi i tij, dhe Kryetari. Proces-verbalet e mbledhjeve të Bordit arkivohen.
2. Vendimet hartohen në dy kopje, njëra prej të cilave arkivohet dhe tjetra i dërgohet njësisë/njësive përkatëse për zbatim.

b. I propozon Senatit, ndryshime në nivelin e tarifave te studimit, pasi i ka miratuar ato paraprakisht në mbledhjen e tij të radhës;
c. I propozon Senatit, kategoritë sociale dhe bursat e ekselencës për çdo vit akademik, të cilët përfitojnë bursa studimi, pasi i ka miratuar ato paraprakisht në mbledhjen e tij të radhës;
d. miraton Rregulloren e funksionimit të tij.

Neni 4

1. Bordi i Administrimit të AU përbëhet nga 7 anëtarë, ku 3 (tre) anëtarë të Bordit të Administrimit emërohen nga Senati, të cilët janë pjesë e personelit akademik në AU, dhe 4 (katër) anëtarët e tjerë, emërohen nga Administratori i Shoqërisë Tregtare (SHT), ku vetë Administratori i Shoqërisë, është *ipso jure* një nga katër anëtarët.
2. Anëtarësia në Bordin e Administrimit, në respektim të nenit 48, pika 6 te Ligjit Nr. 80/2015 është e papajtueshme me detyrën e Rektorit, të Dekanëve, të Përgjegjësit të Departamentit, si dhe të Administratorit të përgjithshëm dhe Administratorëve të njësive kryesore të AU.

Neni 5

1. Emërimi i anëtarëve, pjesë e personelit akademik të AU në Bordin e Administrimit bëhet mbi bazë të kandidaturave alternative, të propozuar në mbledhjen e Senatit nga Rektori i AU, mbas konsultimeve paraprake me titullarët e njësive kryesore dhe atyre bazë.
2. Senati Akademik, përzgjedh midis kandidaturave alternative, 3 (tre) anëtarë për tu përfaqësuar në Bordin e Administrimit, të cilët kanë një background profesional në fushën e financiare dhe atë të drejtimit administrativ.
3. Anëtarët e tjerë të Bordit të Administrimit që emërohen nga Administratori i Shoqërisë Tregtare (SHT), mund të jenë persona të punësuar brenda SHT, por edhe jashtë saj. E drejta e emërimit të tyre, është në diskrecion të Administratorit të SHT.
4. Mandati i anëtarëve të Bordit të Administrimit është 5 (pesë) vjet.

Neni 6

Bordi i Administrimit, drejtohet nga Administratori i SHT, i cili është edhe kryetar i Bordit të Administrimit.

Neni 7

1. Në mbledhjet e Bordit të Administrimit, përveç anëtarëve me të drejtë vote, mund të marrin pjesë pa të drejtë vote edhe: Administratori i Përgjithshëm i AU, Administratorët e njësive kryesore; Rektori; Dekanët, dhe Shefat e Departamenteve.

Neni 15

1. Me propozim të Senatit, Bordi i heq mandatin anëtarit të zgjedhur prej tij, kur anëtari i Bordit :

a. largohet nga Universiteti;
b. mungon pa arsye në 3 seanca radhazi;
c. në raste paaftësie fizike apo mendore për të ushtruar funksionin;
d. në rastin e shkeljeve të rënda të Ligjit;
e. kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, që cënon rëndë personalitetin dhe integritetin e tij dhe që lidhet ngushtë me ushtrimin e këtij funksioni.

2. Me propozim të Administratorit të SHT, Bordi i heq mandatin e anëtarit të emëruar, kur:

a. Largohet nga SHT;
a. mungon pa arsye në 3 seanca radhazi;
b. në raste paaftësie fizike apo mendore për të ushtruar funksionin;
c. në rastin e shkeljeve të rënda të Ligjit;
d. Kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, që cënon rëndë personalitetin dhe integritetin e tij dhe që lidhet ngushtë me ushtrimin e këtij funksioni.

3. Me largimin e një anëtari të Bordit, në kushtet e parashikuara nga pikat 1 dhe 2 të këtij neni, bëhet zëvendësimi i tij, sipas rregullave të parashikuara në nenin 5 të kësaj Rregulloreje brenda 1 muaj nga dita e largimit.

Neni 16

Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit në Bordin e Administrimit dhe firmosjes nga Kryetari i tij.

Miratuar me Vendimin nr. 4 të Bordit të Administrimit, datë 22.12.2016.

ALBANIAN UNIVERSITY
AU